


KOMUNA E GJAKOVËS



Memorandum Bashkëpunimi

Ndërmjet

Komunës së Gjakovës

dhe

Gurmania JSC

PËR

FESTIVALIN "MISH MISH VIKENDI"

Gjakovë, 1 Korrik 2019

Përmbajtja e Eventit “MISH-MISH FESTIVALI”

Mish-Mish Festivali do të jetë Event i parë në Kosovë në përkrahje të Industrisë së Mishit dhe Produkteve Vendore.

Eventi do të organizohet në formën e një Festivali të Ushqimit, aktivitete këto të mirënjohura në botë, ku krahas prezantimit të ushqimit do të bëhet në përcjelljen e muzikës.

Industria e Mishit do të përfaqësohet nga:

- Prodhues të Mishit të Kuq, Shpezëve si dhe të Peshkut;
- Prodhues Vendore nga Industria e Ushqimit;
- Përpunues të produkteve të Mishit të Kuq, Shpezëve dhe të Peshkut;
- HoReCa të Specializuara në gatimin e mishit (p.sh.Steak House);
- Dyqane Tradicionale/ Qebaporet famshme kosovare;

Në Mish-Mish Festival do t'i epet hapësirë edhe industrive tjera ushqimore, siç janë pijet alkoolike dhe joalkoolike, prodhuesit e produkteve të qumështit, brumërat dhe sektorët tjera të industrisë së ushqimit.

Në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit do të përgatiten hapësira të veçanta për përgatitjen e produkteve dhe servimin e tyre.

Industria e mishit do të jetë bartëse e festivalit dhe do të ketë hapësirat qendrore kurse tjerat do të jenë përcjellëse.

Mish-Mish Festivali do të mbahet me datën **20 Korrik, në Gjakovë.**

Qëllimi Memorandumit

Qëllimi i këtij memorandum është:

- Prodhuesit vendorë do të forcojnë imazhin e tyre dhe si rrjedhojë do të rrisin shitjet gjatë festivalit dhe në vazhdimësi;
- Konsumi i produkteve nga prodhues të huaj do të pasoje rënie duke u zëvendësuar gjithnjë e më shumë nga produkte vendore;
- Konsumatori Kosovar do të fillojë të ndihet faktorë i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit tone;
- Festivali Mish-Mish do të bëhet tradicional;

Rolet e Palëve

Bashkëpunimi i këtij memorandum realizohet si në vijim:

Komuna e Gjakovës do të bënë: Sigurimi lokacionit, Shpenzimet logjistike(rryme, etj.), Shpenzimet teknike(bina, zërmë dhe video) dhe Shpenzimet e pritnit;

GURMANIA JSC do të bënë pjesën tjetër të organizimit si: Do të fton Prodhuesit vendore; Mysafiret (këngëtarët), do të merret me stafin teknik, Kampanjën, Mirëmbajtjen eventit;

Zbatimi i Memorandumit

Palët do të caktojnë person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në rastet e shmangies nga procedurat e përcaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zgjidhja e Memorandumit


Në rast të çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me mos përmbushjen e obligimeve që i kanë palët në këtë marrëveshje, palët negociojnë në mirëbesim për të arritur një zgjidhje miqësore, në mungesë të konsensusit, kontestin në mes të palëve do ta zgjidh Gjykata Themelore në Gjakovë.

Ky memorandum është e përpiluar në katër (4) kopje, prej të cilave dy prej të cilave depozitohen në GURMANIA JSC, dhe dy të tjera në Komunës së Gjakovës

Ky Memorandum Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve datë: 25.06.2019

PALËT

Komuna e Gjakovës


Ardian Gjini

Gurmania JSC


Fisnik Vejsa

